

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Sherbim trajtimi me ushqim ditor dhe katering per te moshuarit sipas projektit social

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 55520000-1 - Shërbime katering, 55500000-5 - Shërbime në mensa dhe shërbime katering

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,227,600 (nje milion e dyqind e njezete e shtate mije e gjashteqind) leke pa tvsh.

Ne mbështetje të ligjit nr. 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit të përcaktuar e cila nuk është e lartë dhe vlera 40% e fondit limit për xhiro vjetore nuk cenon pjesëmarrjen e op.ekonomik as atyre që janë biznes i vogël duke garantuar konkurrencë të hapur dhe mos cenimin e asnjë op.ekonomik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023,2024,2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma**

“c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Kerkohet per 3 vitet e fundit duke marre ne konsiderate vleren e objektit dhe per te qen sa me konkuruese per te gjithë op.ekonomik te vegjel apo te medhenj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo me te vogel se 20 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke parë vlerën e fondit limit për këtë objekt mendojmë që marzhi i përcaktuar 20 % i cili është dhe maksimali për këtë model procedure vendoset për të demonstruar që op.ekonomik kanë furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jep garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit. Nuk e kalon vlerën e përcaktuar në ligj si dhe termi i përdorur jo më pak se 20% është sugjerim i Agjencisë së Prokurimit Publik. Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë op.ekonomik pasi është e përballueshme dhe në proporcion të plotë me objektin

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër plotesimin e specifikimeve teknike si dhe te sasise se kerkuar sipas te gjitha standarteve dhe normave qe parashikon legjislacioni ne fuqi per perdorimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore per njerzit.
- Subjekti duhet të deklarojë se do marre persiper ofrimin e sherbimit prane qendres sociale dhe ta mundesoje sherbimin nepermjet eneve perkatese te guzhines plastike,nje perdorimshe dhe sipas standarteve dhe normave ushqimore.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ,në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”Me ane te ketij kriteri op.ekonomik merr persiper angazhimin per plotesimin e kriterëve dhe kushteve teknik per zbatimin e objektit te kontrates sipas te gjithave stadarteve ligjore per ofrimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore,si dhe ofrimin e ketij sherbimi prane vendit te percaktuar nga Bashkia Puke ne perputhje me projektin social qe po zbaton aktualisht me mbeshtetjen e Qeverise Shqiptare ne fondin social.

Specifikimet teknike jane te vendosura nga specialisti perkates i cili ka hartuar dhe specifikimet dhe preventivin perkates per kete objekt.Fondi limit eshte ne përputhje me implementim e kontrates per zbatimin e këtij projekti social ku jane përcaktuar vaktet ndersa vlere ditore eshte ne zbatim te shkreses nr.5055/20 date 29.12.2025 per përcaktimin e kuotave sipas VKM per grup moshat dhe konkretisht moshen e trete per te cilen do zbatohet ky projekt social.Menuja eshte përcaktuar nga punonjësit social sipas studimit perkates te tregut ne përputhje me koten ditore per moshen e trete.

Njesia Prokurimit

Genola Kula

Iris Latifi

Alda Gjoka